

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 31, datë 18.12.2018

Për miratimin e një ndryshimi në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”


Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “ll” dhe shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “i”, të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, shkronja “l” të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Komitetit të Investimeve sipas Vendimit të tij nr. 9, datë 11.12.2018, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Në Rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- a) Në nenin 14, pika 1, shkronja “a” ndryshohet me përmbajtjen si vijon:

“a) Transhi i likuiditetit, i cili shërben për mbulimin e nevojave në rast ngjarjeje sigurimi të mundshme dhe nevojave për mbulimin e shpenzimeve për veprimtarinë vjetore të Agjencisë. Ky transh përfshin gjendjen në llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur 0 - 3 muaj. Madhësia e këtij transhi në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 10% e totalit të mjeteve financiare për secilin nga fondet e administruara nga Agjencia.”



KËSHILLI DREJTUES

2. Ngarkohet Komiteti i Investimeve, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës dhe Riskut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar